



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1589/4 Prot.

Gjirokastrë, më 09/12/2020

V E N D I M

Nr. 40, datë 09.12.2020

**MIRATIMI I SHPALLJES JO AKTIVE I PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR VITIN
AKADEMIK 2020-2021**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 418, datë 10.05.2017 "Për Standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", dhe Vendimit nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Vendimit nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", udhëzimit nr. 23, datë 28.09.2020, për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" i ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 22, datë 03.09.2020, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre,

njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të të arsimit të lartë” ;

Senati Akademik i Universitetit “Eqrem Çabej në mbledhje e tij të datës, 09. 12. 2020, diskutoi rreth të gjitha programeve të studimit pas përfundimit regjistrimeve të reja në vitin akademik 2020 – 2021.

Pas diskutimeve, Senati Akademik vlerësoi gjendjen e këtyre programeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe bëri një identifikim të programeve të studimit të cilat, për dy vite të njëpasnjëshme akademike nuk kanë patur studentë të regjistruar.

Në përfundim të diskutimeve Senati Akademik;

V E N D O S I :

1. Miratimin dhe shpalljen jo aktive për vitin akademik 2020 - 2021 për mos regjistrimin e studentëve për dy vitet të njëpasnjëshme në programet e studimit të mëposhtme:
 - Program i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Matematikë – Fizikë
 - Program i studimit të ciklit të parë “Bachelor ” në Fizikë dhe Teknologji Informacioni
 - Program i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Gjuhë Italiane
 - Program i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Biologji Mjedisë dhe Zhvillimi
 - Program i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Gjuhësi
 - Program i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Letërsi
 - Program i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Mësuesi për Arsimin Fillor klase I-VI
2. Universiteti “Eqrem Çabej”, në përputhje me kuadrin ligjor do të ndjekë procedurat për mbylljen e këtyre programeve të studimit në zbatim të udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit “Eqrem Çabej”.

R E K T O R

Prof. dr Bektash MEMA

